



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:055685

Datë: 29.09.2023

Numri i dokumentit: 04735925

C.nr. 11/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshëm – Divizioni civil, me gjyqtar Sabaheta Kurteshi dhe procesmbajtës Senida Nuri, në çështjen juridiko- kontestimore të paditësve, R. A. me numër personal..., me vendbanim në K. dhe S. A. me numër personal..., me vendbanim në K., Komuna e Dragashit, te cilët me autorizim i përfaqëson av. V. O., nga Prizreni kundër te paditurës Kompania e sigurimeve „S.” me seli ne Prishtin rr” Q. H. “.nr..., te cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e avokateve “ A.” rr “ B. 1...” D. R. H.-Prishtine, lidhur me padinë për kompensim dëmi, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor me datë 06.09.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve S. A. dhe R. A. me vendbanim në fshatin..., Komuna e Dragashit me te cilën kanë kërkuar qe te **DETYROHET** e paditura Kompania e sigurimeve „S.” me seli ne Prishtin rr” Q. H. “.nr..., te cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e avokateve “ A.” rr “ B. 1...” D. R. H.-Prishtine, që në emër të dëmit material dhe atij jo material për paditësen S. E. t’ia kompensoj shumat si në vijim:

a). Dëmi jo material:

- Për dhimbje fizike (trupore) për të gjitha format shumë prej3.300,00 €
- Për frikë shumë prej:1.500.00 €
-Për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor për.....	2.300,00 €

b). Dëm material:

- Për ushqim të përforcuar, shumë prej	150,00 €
- Për shpenzimet e mjekimit shpenzimet e shërimit, terapisë vesh mbathje, shumen prej	1,100.00 €

E krejt në shumë prej **8.350,00€**, me kamat vjetore ligjore prej 8% duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit e gjer në pagesën përfundimtare, si dhe

Për paditësin R. A.,nga fshati..., Komuna e Dragashit me te cilën kanë kërkuar qe te **DETYROHET** e paditura Kompania e sigurimeve „S.” me seli ne Prishtinë rr” Q. H. “.nr..., që të bëjnë pagesën në emër të kompensimit te demit material për veturën e te markës “VW Golf “ me targa te regjistrimit..., në shumë të përgjithshme prej 4,875.89 euro, me kamat vjetore ligjore prej 8% duke llogaritur nga dita e marrjes së aktgjykimit e gjer në pagesën përfundimtare

dhe shpenzimet e procedurës ne shume prej 2,159.20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit e nën kërcenim të ekzekutimit të dhunshëm **SI E PA BAZUAR**

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Pala paditëse përmes te Autorizuarit AV. V. O. kanë paraqitur padi kësaj gjykate me date 24.03.2021 kundër te paditurës Kompania e sigurimeve „S.” me seli ne Prishtinë rr” Q. H. “.nr..., duke i propozuar gjykatës qe pas administrimit te provave si ne padi raportin e policisë me nr. 2015-GD-35 të dt. 23.02.2015; raportin mjekësor lëshuar nga Spitali Rajonal në Prizren me nr. të protokollit 4362/234, raporti nga konsulta me nr. 750 të dt. 02.03.2015 për S. A., raporti mjekësor i pediatriisë për S. A. i dt. 03.10.2017, raporti i ekspertit mjeko ligjor për S. A. i dt. 19.06.2015, procesverbal mbi dëmtimin e automjetit i dt. 24.02.2015 si dhe fatura tjera të bashkangjitura shkresave të lëndës, duke i propozuar gjykatës qe e njëjta te aprovohet si e bazuar. Edhe përgjatë shqyrtimit kryesor i autorizuari i paditësve av.V.O., nga Prizreni, ka mbetur në tërësi pranë theksimeve në padi dhe kërkesëpadi të precizuar duke i propozuar gjykatës që të njëjtën ta aprovojë si të bazuar. Deklaron: mbetëm në tersi pranë padis dhe krekëspadis e precizuar në parashtrësën e datës 24.03.2021, i cili precizim është ber pas pranimit të mendimit të eksperteve të Ortopedisë dhe Psikiatriisë ndaj te cilëve mendime si palë paditëse nuk kemi vërejtje dhe për palën paditëse nuk është e nevojshme prezenca e eksperteve për të sqaruar faktet tjera pos atyre të konstatuara në mendimet e dhëna. Po ashtu gjykatës i dorëzojmë nga një kapje te urdhër pagesave për ekspertet e angazhuar, ndërsa në fjalën e vet përfundimtare ka deklaruar: mbetemi pranë padisë dhe kërkesëpadisë së precizuar duke i propozuar gjykatës që provat të cilat u administruar në këtë çështje kontestimore të i falët besimi i plot për faktin se vërtetojnë gjendjen faktike lidhur me shkaktarin e aksidentit, lartësinë e dëmit material, natyrën dhe karakterin e lëndimeve trupore të paditësës S. A. si dhe intensitetin e frikës e përjetuar nga e njëjta. Sa i për këtë pretendimeve të parashtruara nga e paditura se kjo çështje juridike tani më është parashkruar jep pretendimin e tillë konsiderojmë se nuk ka bazë ligjore për faktin se para inicimit të procedurës gjyqësore sipas kërkesa së palëve është zhvilluar një procedurë administrative pranë të paditurës fakt i cili dëshmon edhe me përpilimin e procesverbalit nga vet e dëmtuara mbi dëmtimin e automjetit sipas dispozitave të LMD-së çdo kërkesë për realizimin e drejtës paraqet rrethanë të ndërprerjes të afatit të parashkrimit. Andaj gjykatës përfundimisht i propozojmë që kërkesëpadinë e paditësve të precizuar me parashtrësën e dt. 04.04.2022 të aprovoj si të bazuar lidhur me lartësinë e dëmit material dhe jo material duke llogaritur dhe kamatën ligjore si dhe shpenzimet e procedurës të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së Aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Përfaqësuesi i te paditurës si në përgjigje në padi ku ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi ndërsa gjatë shqyrtimeve kryesore ka deklaruar: e kundërshtojmë kërkesëpadinë si për nga baza ashtu dhe për nga lartësia për faktin se sipas raportit fillestar të policisë vërehet qe automjeti “A” pronë e paditësit R. A. dhe pasagjeres në cilësinë e paditësës së dytë S. A. e cila ka qen në automjetin “A” vërehet se kemi të bëjmë me vet aksident dhe i siguruari i të paditurës nuk ka pikë kontaktin me automjetin “A”, po ashtu edhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kontestuar kërkesëpadinë vetëm sa i përket lartësisë. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e konteston bazën juridike të kërkesëpadisë por vetëm lartësinë e kërkesës, duke theksuar se e

kundërshtojmë kërkesëpadinë pasi që kërkesa për kompensimin e dëmit material ka arritur parashkrimi duke marr parasysh aksidentin me dt. 23.02.2015 dhe padinë e kanë ushtruar në gjykatë me dt. 24.03.2021, ndërsa në fjalën e vet përfundimtar përfaqësuesi M. D. ka deklaruar: me administrimin e provave në këtë çështje juridike nuk është arritur të bëhet e besueshme baza juridike e kërkesëpadisë të palëve paditëse andaj vlerësojmë se me këtë çështje ashtu siç kemi theksuar më lart padia e paditësve është parashkruar dhe pretendimet e palës paditëse se procedura jashtë gjyqësore e ka ndërpre parashkrimin nuk gjej bazë ligjore pasi që LMD-ja e parasheh vetëm në rastet e paraqitjes së padisë. Andaj kërkoj nga gjykata që me rastin e vendosjes kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar. Lidhur me shpenzimet kërkojmë që të vendoset në bazë të suksesit në procedurë dhe të njëjtat ti kërkojmë për dy përfaqësime në seanca në shumën e përgjithshme prej 540 € prej nga 270 € për dy seanca.

Gjendja faktike e vërtetuar

Për vërtetimin e drejtë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore, gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: është bere shikimi në raportin nga vendi i ngjarjes të dt. 23.02.2015, shikimi në raportet mjekësore të dt. 23.02.2015, bëhet leximi në testet alergologjisë të lëkurës të dt. 03.10.2017, bëhet leximi i raportit nga konsulta të dt. 02.03.2015 nga ana Spitalit rajonal në Prizren, është lexuar procesverbali mbi dëmtimin e automjetit, shqimi në faturat tatimore të cilat janë regjistruar në shkresat e lëndës nga faqja 10 deri në faqen 23 ku bëhet dhe leximi i dokumentit Unik doganor dhe Certifikatës mbi konfirmimin e rregullsisë teknike të automjetit. Lexuar ekspertiza të ing i diplomuar R. Sh., vlerësues i licencuar, të dt. 01.10.2021, lexohet përmbajtja e ekspertizës mjeko ligjore të dr. Xh. K. ortoped – traumatolog, ekspertiza e ekspertit A. S. – inxhinieri i diplomuar si dhe ekspertiza mjeko ligjore psikiatrike dr. sci, N. F., lexohet mendimi i Zyrës shërbyese EKS Blakaj – ekspertit mjeko ligjor dr. sci F. B. të dt. 19.06.2015, si dhe janë dëgjuar ekspertet si me larte.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqësve dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është **e pa bazuar**.

Gjykata pas vlerësimit të raporteve dhe atë : raportit nga konsulta të dt. 02.03.2015 nga ana Spitalit rajonal në Prizren, shihet se ka pas një kontroll këtu paditësja S. E. ku dhe është caktuar dhe diagnoza (shih me gjerësisht si ne raport), raportit të neurologut të dt. 02.03.2015 neurologu e përshkruan si lëndim trupor tronditje trunore të pacientit “e shkruar Cometio ceirbri” e ne bazë të cilave raporte mjekësorë është dhënë mendimi nga ana e Zyrës shërbyese EKS Blakaj – ekspertit mjeko ligjor dr. sci F. B. të dt. 19.06.2015, ku nga dëmtimet e përshkruara ne gjetje paraqesin si ndrydhje të indeve të buta të kokës dhe tronditje trunore etj që si të tilla bëjnë pjese ne dëmtime të lehta trupore andaj gjykata konstaton se këtu paditësja S. E. ka pësuar lëndime të lehta trupore të përshkruara me gjerësisht si ne mendim e lëndime të renda trupore.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të përfaqësuesit të palës së paditur të parashtruar përmes përgjigjes në padi, ku ka kontestuar kërkesëpadinë e paditësve në tërësi, ndërsa gjatë shqyrtimeve kryesore ka deklaruar se me administrimin e provave në këtë çështje juridike nuk është arritur të bëhet e besueshme baza juridike e kërkesëpadisë të palëve paditëse andaj vlerësojmë se me këtë çështje ashtu siç kemi theksuar më lart padia e paditësve është parashkruar dhe kërkoj nga gjykata që me rastin e vendosjes kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj në tërësi si të pa bazuar, ka gjetur se nuk është kontestuese se rasti ka ndodh me datë ,23.02.2015 ora

16:40 minuta ne rigën regjionale nga Dragashi ne drejtim te Prizrenit, saktësuesit ne udhëkryqin e fshatit B. — Komuna Dragashit, ku deri te aksidenti ne komunikacion ka ardhur për derisa ngasësi i automjetit “VW GOLF” 04-1...-... duke lëvizur për gjate rrugës regjionale nga Prizreni ne drejtim te Dragashit, me te arritur te udhëkryqi i fshatit B., nga drejtimi i kundërt nga Dragashi ne drejtin te Prizrenit ishte duke lëvizur automjeti B "VW PASSAT", i cili kishte për qellim kalimi majtas për ne rrugën e fshatit B., ku ngasësi i automjetit A "VW GOLF" për ti ikur goditjes se drejtpërdrejt , del jashtë rrugës ne anën e djathte dhe godet shtyllën prej betoni tek lapidari i dëshmorit “Ruzhdi Berisha”, me ç ‘rast shkaktohet aksident ne komunikacionin rrugor, ku si pasoj e vet aksidentit lëndime te lehta trupore ka pësuar bashkudhëtari ne automjetin A, më gjerësisht sikurse në këtë raport. Automjeti të cilin e drejtonte M. P. në momentin e shaktimit të aksidentit, ka qenë i siguruar tek e paditura, sepse i siguruari tek e paditura kishte bërë shkelje të rregullave të komunikacionit siç edhe është cekur më lartë, ky fakt është provuar përmes aktgjykimit penal të Gjykatës Themelore në Prizren Dega Ne Dragash P.nr.31/2018, të datës 16.10.2018, në bazë të të cilit shihet qartë se ndaj të akuzuarit M. P. gjykata e kishte shpallur fajtorë, dhe e ka dënuar me dënim me gjobë për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me paragrafin 1 te KPRK-es, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale në kuptim të nenit 91 par.6 të KPK–së.

Gjykata në kuptim të rrethanave të konstatuara më lartë dhe duke vlerësuar prapësimin e të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjeti se kërkesa e paditësve është parashkruar. Duke u bazuar ne dispozitat te Ligjit për Marrëdhëniet e detyrimeve Ligji nr.04/L-077 neni 357 paragrafi 1 parasheh citoj “ Kërkesa për shpërblimin e dëmit parashkruhet për tri vite nga data kur i dëmtuari ka marr dijeni për dëmin dhe personin i cili e ka shkaktuar dëmin “ ndërsa paragrafi 2 i të njëjtit nene parasheh citoju “ në çdo raste kjo kërkesë parashkruhet për pesë viti nga shaktimi i dëmit “ e që në këtë rast pala e dëmtuar ka pas dijeni për aksidentin e shkaktuar dhe dëmin.

Gjithashtu Duke u bazuar ne dispozitat te Ligjit për Marrëdhëniet e detyrimeve Ligji nr.04/L-077 duke vlerësuar dhe kërkesën e te paditurës se kemi parashkrim atëherë nga këto dispozita ligjore del se kërkesa për kompensim dëmi parashkruhet, shihe neni 358 citoj “kemi të bëjmë me kërkesën për kompensim dëmi të shkaktuar me veprë penale”. Sipas nenit 358.1 te Ligjit për Marrëdhëniet e detyrimeve Ligji nr.04/L-077 parasheh citoj : ”Kur dëmi është shkaktuar nga vepra penale dhe për ndjekjen penale është parashkruar një afat më i gjatë parashkrimi, kërkesa ndaj personit përgjegjës parashkruhet kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale”. Marrë parasysh se sipas aktgjykimit penal të Gjykatës Themelore në Prizren Dega Ne Dragash P.nr.31/2018, të datës 16.10.2018, në bazë të cilit shihet qartë se i akuzuari M. P. gjykata e kishte shpallur fajtorë dhe e ka dënuar me dënim me gjobë për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 378 par.6 lidhur me paragrafin 1 te Kodit penal i Republikës së Kosovës Kodi.nr.04/L-082(KPRK-es) ashtu qe ne kuptim të nenit 106 pika 1.6 të KPRK–ës së ka parashkrimit absolut të ndjekjes penale me arsye se sipas aktakuzës se Prokurorisë Themelore ne Prizren vepra penale është kryer me dt. 23.02.2015 asht qe duke u bazuar ne datën e kryerjes se veprës penale është konstatuar se ka arritur parashkrimi absolut për ndjekje penale për këtë veprë penale për të cilën është paraparë dënim me gjobë ose burgim deri në 1 vjet, neni 106 par 1 pika 1.6 citoj “Ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 vite nga kryerja e veprës penale të dënueshme deri 1 (një) vit burgim ose me dënim me gjobë” ndërsa sipas nenit 107 par.1 të KPRK–së ku është e përcaktuar se: “ afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon nga dita kur është kryer vepra penale. kurse dispozita e nenit 107 paragrafi 8 pika 1.6 të KPRK–së është përcaktuar se: ”Ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit” (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale)”.

Andaj meqenëse nga koha e kryerjes së veprës penale 23.02.2015 dhe paraqitjes së padisë me datë 24.03.2021, kanë kaluar më tepër se 6 vite, gjykata ka gjetur se ka ndodhur parashkrim absolut i ndjekjes penale e i cili ka arritur me dt.23.02.2021. Andaj sipas nenit 358.1 i LMD-ku kërkesat e shpërblimit të dëmit të shkaktuara me veprën penale thuhet se parashkruhen kur të skadojë koha e caktuar për parashkrimin e ndjekjes penale dhe kjo kohë ka kaluar me dt.23.02.2021 atëherë edhe çështja civile dhe parashkrimi i saj është e lidhur me këtë nen ku kemi parashkrim të padisë dhe kërkesëpadisë së paditëses dhe nuk ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga e paditura - debitori.

Në rastin konkret afati i paraparë ligjor me dispozitat e cekura më lartë ligjore të LMD-së, Andaj pala paditur me të drejtë thirret në atë se kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës së palës paditëse dhe gjykata si të tillë e mori si të bazuar.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është bazuar në dispozitat e neneve 452.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura dhe bazuar në dispozitat e nenit 358.1 të Ligjit për Marrëdhëniet e detyrimeve Ligji nr.04/L-077 lidhur me nenin 143 par.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2021:055685, 06.09.2023**

G j y q t a r i / j a

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit, nëpërmjet të kësaj Gjykate.